



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 4920 Prot.

Tiranë, më 07.05.2018

URDHËR

Nr. 224, datë 07.05.2018

PËR

TESTIMIN PARAPRAK TË MATURANTËVE


Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26, pika a, dhe 49, pika b, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zhvillimin e testimit paraparak të maturantëve, ditën e premte, më datë 11 maj 2018, ora 11:00-12:00.
2. Testimi do të zhvillohet në 26 gjimnaze (2 gjimnaze të përzgjedhura për testim në çdo DAR), në lëndët “Gjuhë shqipe-letërsi” dhe “Matematikë”. Gjysma e maturantëve të çdo gjimnazi do të testohet në lëndën “Gjuhë shqipe-letërsi” dhe gjysma tjetër në lëndën “Matematikë”.
3. Testet do të hartohen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.
4. Testimi do të administrohet nga DAR-të përkatëse dhe do të monitorohet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

5. Vlerësimi i testeve do të bëhet nga DAR-të përkatëse, të cilat, brenda datës 20 maj 2018, do të dërgojnë zyrtarisht në QShA, në formë të shkruar dhe elektronike raportin për rezultatet e testimit paraprak.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe drejtoritë arsimore rajonale.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

